

HAP PAS HAPI

Trajnimi për mentor për ngritje të cilësisë së mësimdhënies

Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:

- Njohuri për rolet dhe përgjegjësitë e mentorit.
- Aftësi dhe shkathtësi për përkrahjen e zhvillimit profesional të mësimdhënësve.
- Njohuri për ciklin e mentorimit
- Aftësi për përdorimin e mjeteve dhe të teknikave të reja për mentorim të mësuesve në shërbim, duke përfshirë planifikimin, vëzhgimin, reflektimin dhe zbatimin.
- Njohuri rreth zbatimit të standardeve pedagogjike të ISSA (Asociacionit ndërkombëtar të programit "Hap pas Hapi")

Përmbajtja e trajnimit

Çka është profesionalizmi dhe cilat janë komponentët e profesionalizmit në mësimdhënie. Karakteristikat dhe rolet e mentorit. Standardet pedagogjike ndërkombëtare të ISSA (Asociacionit ndërkombëtar të programit "Hap pas Hapi").

Të njohim dhe përdorim standardet në praktikë. Vëzhgimi praktik në klasë duke përdorur instrumentet e vlerësimit. T'i njohim faktet kundruall mendimeve të cilat dalin nga vëzhgimet në praktikë. Si punojnë mentorët me mësuesit të cilët zbatojnë programin "Hap pas hapi" në nivele të ndryshme. Rolet primare të mentorit. Cikli i mentorimit.

Puna me mjete specifike të mentorimit si parafrazimi, pushimi dhe pyetjet nxitëse. Të kuptuarit dhe praktikimi i bisedave të mentorimit për planifikim dhe reflektim.

Grupi i synuar

Ky program trajnimi u dedikohet mësimdhënësve, zyrtarëve të lartë të arsimit, pedagogëve, psikologëve, punonjësve social, me më shumë përvojë në programin "Hap pas Hapi" të cilët mund t'iu ndihmojnë mësimdhënësve fillestarë.

Forma e organizimit/Kohëzgjatja

Trajnimi për mentor për ngritje të cilësisë së mësimdhënies, organizohet brenda 4 ditëve, gjithsejtë 30 orë trajnimi. Gjatë kësaj kohe përfshihet edhe puna praktike në institucione parashkollore apo shkollore.

Certifikimi

Kusht për certifikim është pjesëmarrja 90% në trajnim.